



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/09/ 2023

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/09/2023

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2023

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____09/2023, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 11 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin GUSHT 2023 për 273 familje me një fond prej **1.180.525** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social B.Musaj

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lufti Lala



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____._____.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____._____.2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ardjan Shefit Kotorri, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasit **Z. Ardjan Shefit Kotorri**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në shumën **44,863** (dyzetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $89,726^1 \times 50\% = 44,863 + 162,000^2 = 206,863$ lekë.
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **206,863** (dyqind e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, për familjen e **Z. Ardjan Shefit Kotorri**, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në orendi e pajisje

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist
Përgj. Sektori

I. Hoxholli
Xh. Kapllanaj

Pranoi:

Drejtori EC

N. Sinani

Miratoi:

Drejtori PSHI

S. Mehmeti

Konfirmoi:

Zv/ Kryetari

A. Bylykbashi



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____._____.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____._____.2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Fatime Gure Selimi, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasës **Znj. Fatime Gure Selimi**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në shumën 95,901 (nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e një) lekë. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $191,803^1 \times 50\% = 95,901 + 120.000^2 = 215.901$ lekë.
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **215.901 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e një) lekë**, për familjen e **Znj. Fatime Gure Selimi**, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në orendi e pajisje

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist
Përgj. Sektori

I. Hoxholli
Xh. Kapllanaj

Pranoi:

Drejtori EC

N. Sinani

Miratoi:

Drejtori PSHI

S. Mehmeti

Konfirmoi:

Zv/ Kryetari

A. Bylykbashi



REPubLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____._____.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____._____.2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së Z. Petrit Ramazan Çikoja, banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë dhe dhënien e shpërbllimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërbllimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së Z. **Petrit Ramazan Çikoja**, banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë, prej **1.356.335 (një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë)**.
2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët $2.712.670^1 \times 50\% = 1.356.335$ (një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist
Përgj. Sektori

I. Hoxholli
Xh. Kapllanaj

Pranoi:

Drejtori EC

N. Sinani

Miratoi:


Drejtori PSHI

S. Mehmeti

Konfirmoi:

Zv/ Kryetari

A. Bylykbashi





REPUBLICA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . 09. 2023

P/VENDIM

NR. _____ DATË ____ . 09. 2023

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . 09 .2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Të miratoje “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETAR
Lutfi Lala

P.Sekt.Buxhetit: M.Beluli

Dr.Buxh.Fin.: A.Merkja

D.P.P.A.B.F: Q.Tusha

D.P. Sh. O: D. Meta

D.P. Sh. O: A.Lulaj

D.P.Sh..I : S.Mehmeti

Dr.Juridike : A.Hoxha

ZV/Kryetar : A.Bylykbashi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .09. 2023

P/VENDIM

NR. _____, DATË ____ . 09. 2023

MBI

“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026, FAZA E DYTË”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë ____ .09.2023, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi miratimin e fazës së dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.6, datë 28.02.2023 dhe nr.21, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”

VENDOSI :

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, të rishikuar (faza e dytë), për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETAR
Lutfi Lala

P/Sekt.Buxhetit : M.Befuli

Dr.Buxh.Fin.: A.Merkja

D.P.Sh.M : Q.Tusha

D.P.SH.O : D.Meta

D.P.SH.I : S.Mehmeti

D.P. Sh. O: A.Lulej

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : A.Bylykbashi



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, ____ .09. 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë: ____ .09. 2023

“Miratim fondi për transportin e sekretarëve në shkollat e arsimit parauniversitar.”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 05/09.2023, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Drejtoria Buxhet Financë “Miratim shpenzime për transportin e sekretarëve në shkollat e arsimit parauniversitar” dhe mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.190, datë 27.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2023, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e pagesës së transportit për sekretarët e punësuar në shkollat e arsimit parauniversitar të cilët punojnë në distancën mbi 5 km deri në 50 km larg vendbanimit të tyre të përhershëm dhe kthehen brenda ditës në vendbanim.
2. Miratimin e fondit 34,800 lekë, në Qendrën Ekonomike të Arsimit, programi 09230, shpenzime transporti të sekretarëve në shkollat e arsimit parauniversitar, për periudhën tetor-dhjetor 2023.
3. Transferimin e fondit rezervë për shumën 34,800 lekë, për financimin e pikës 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

Konc.P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxhet Financë : A.Merkja

Dr. Pergj.: Q.Tusha

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : A. Bylykbashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . 2023

P/VENDIM

NR. _____ DATË ____ . ____ . 2023

“Transferim fonde në buxhetin e vitit 2023, për aktivitete”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Transferim fonde në buxhetin e vitit 2023, për aktivitete”. bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ”Udhëzimin plotësues nr.2, datë 09.01.2023 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.190, datë 27.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2023, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, i ndryshuar,

VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2023, nga të ardhurat, për financimin e aktivitetit në kuadër të projektit “Misioni i Bashkimit European për 100 qytete neutral klimatike dhe të zgjuara deri në vitin 2030”, më poshtë :

Paksohet :

1,900,000 lekë, “Shpenzime për aktivitete”, proram 01110, artikulli 602, njësia shpenz.Bashkia,

Shtohet :

1,900,000 lekë, shpenzime për aktivitetin “Misioni i Bashkimit European për 100 qytete neutral klimatike dhe të zgjuara deri në vitin 2030”, programi 08220, artikulli 602, Q. Artit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit dhe Qendra e Artit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

P/Sekt..Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Finance : A.Merkja
D.P.P.A.B.F: Q.Tusha
Dr.Juridike: A. Hoxha



Workshop i TAIEX mbi Misionin e Qyteteve të Ballkanit Perëndimor të Horizon Europe


ARRITJA E QYTETEVE KLIMATIKE- NEUTRALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Organizuar në bashkëpunim me

Bashkia Elbasan, Shqipëri

24 Tetor 2023

*Seminar me vendndodhje lokale, gjithashtu me
transmetim online.*



Vendndodhja
(per tu vendosur)

Përfituesit

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi

TAIEX Case ID ETT 84491

TAIEX

MOVING FORWARD TOGETHER WITH EU EXPERTISE



Synimi i Workshop-it:

Workshop-i do të mbështesë shkëmbimin e përvojave midis qyteteve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, për të punuar së bashku në transformimin e neutralitetit klimatik, planifikimin dhe zbatimin e veprimeve konkrete në një mënyrë bashkëpunuese për të përmbushur objektivat e misionit duke angazhuar qytetarët dhe partnerët, nën Misionim e Qyteteve Neutrale ndaj Klimës dhe Qytetet Inteligjente nga Horizon Europe si dhe mjetet e veprimit për klimën në dispozicion të qyteteve nën Platformën e Misionit NetZeroCities.

Ekspertët e TAIEX

- **Z. Björn Hugosson**
Kryetari i Klimës
Qyteti i Stokholmit, Suedi

- **Ms Valeria Balotta**
Departamenti i Urbanistikës
Bashkia e Bolonjës, Itali

+ maksimumi 5 ekspertë të tjerë me pozicione të ngjashme në administratat e tyre lokale nga grupi i qyteteve më poshtë:

- Vitoria-Gasteiz, Spanjë
- Zagreb, Kroaci
- Marseille, Francë
- Mannheim, Gjermani
- Guimares, Portugali
- Marseille, Francë
- Pecs, Hungari
- Limassol, Qipro
- Klagenfurt, Austri

Të ftuar /Folës vendas:

(Kryetarët e Bashkive dhe ministrat nga seanca politike në mëngjes këtu, këta do të jenë të vetmit përfaqësues të nivelit politik: të gjithë pjesëmarrësit e tjerë do të jenë në nivel teknik si drejtues të departamenteve të qëndrueshmërisë ose urbanistikës në qytetet e tyre (shumica) ose praktikues urban (pak, me përkatësi të ndryshme: universiteti, shoqëria civile, të gjitha me ekspertizën e nevojshme për të planifikuar/zbatuar veprimet klimatike)

Përfaqësues të nivelit teknik të çdo qyteti në Rrjetin Rajonal të Qyteteve për Ballkanin Perëndimor:

- Podgoricë, Mali i Zi
- Tivari, Mali i Zi
- Leskovc, Serbi
- Sveti Nikollë, Maqedoni
- Novi Pazar, Serbi
- Prishtinë, Kosovë,
- Elbasan, Shqipëri
- •Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë
- Sarajevë.Bosnjë dhe Hercegovinë

+ përfaqësues të dy qyteteve të misionit turk dhe të qytetit të misionit izraelit

- **Z. Eren Yildiz Geyhan**
Drejtor për Ekologjinë dhe Ndryshimet Klimatike
Bashkia e Izmirit, Turqi
- **Mr. Elvin ÖKSÜZ BAYAZITD**
Divizioni i Ndryshimeve Klimatike, Bashkia Metropolitane e Stambollit,
Bashkia e Stambollit, Turqi
- **Z. Assaf Admon**
Shefi i Njësisë së Qëndrueshmërisë
Bashkia Eilat, Izrael

Organizatorët e Elbasanit do t'i shtohen kësaj liste

Mbrojtja e të dhënave: Të dhënat personale të përfshira në këtë dokument përpunohen në përputhje me deklaratën e privatësisë së instrumentit TAIEX në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1725. Kryesuesi duhet të informojë të gjithë personat që marrin pjesë në ngjarje se fotografitë/fotografitë duhet të merren vetëm gjatë një periudhe të caktuar kohore për të lejuar që personat që nuk pranojnë të bëjnë fotografitë e tyre të largohen nga dhoma, përveç nëse të gjithë pjesëmarrësit kanë dhënë shprehjen e tyre për qimim për t'u marrë fotografinë e tyre. Shiko https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/taix_privacy_statement_online.pdf

DRAFT

E martë, 24 Tetor 2023

Koha lokale	
8:30 – 9:30	<i>Kafja e mirëseardhjes dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në vendin e workshop-it</i>
9:30 – 10:00	<p>Fjala e mirëseardhjes nga z. Gledian LLATJA, Kryetar i Bashkisë Elbasan, Shqipëri</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z. Edi RAMA, Kryeministër i Shqipërisë (nëse jo zëvendëskryeministri do të marrë pjesë) • Znj. Mirela KUMBARO, Ministre, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëri • Znj. Ogerta MANASTIRLLIU, Ministre, Ministria e Arsimit dhe Sportit
10:00 – 10:30	<p>Arritja e qyteteve neutrale ndaj klimës: perspektivat e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z. Patrick CHILD, Menaxher i Misionit të Qyteteve dhe Zëvendës Drejtor i i Drejtorisë së Përgjithshme të Mjedisit, Komisioni Evropian • Z. Arbjan MAZNIKU, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, Shqipëri • Z. Edin FORTO, Ministër i Komunikacionit dhe Trafikut, Bosnjë dhe Hercegovinë
10:30 – 11:10	<p>Kryetarët e bashkive në një mision: zbatimi, qeverisja dhe financimi për qytetet neutrale ndaj klimës.</p> <p>Tryezë e rrumbullakët e moderuar nga z. Patrick Child</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z. Emil BOC, Kryetar i Bashkisë së Cluj Napoca, Rumani (ftesa u dërgua të hënën) • Znj. Olivera INJAC, Kryetare e Komunës së Podgoricës, Mali i Zi • Znj. Benjamina KARIĆ, Kryetare e Bashkisë së Sarajevës, Bosnje Hercegovinë (në pritje të agjendës) • Z. Nihad UK, Kryeministër i Kantonit të Sarajevës, Bosnje Hercegovinë (delegat...) • Z. Ljubiša ĆOSIĆ, Kryetar i Bashkisë së Sarajevës Lindore, Bosnje Hercegovinë (konf) • Z. Gledian LLATJA, Kryetar i Bashkisë Elbasan, Shqipëri (konf)
11:10 – 11:30	<i>Pushim kafeje</i>
11:30 – 11:50	<p>Mjetet e duhura për qytetet neutrale ndaj klimës: burimet e platformës së misionit NetZeroCities në kontekstin e Ballkanit Perëndimor</p> <p>Prezantimi nga z. Thomas OSDoba, koordinatori i NetZeroCities, EIT Climate-KIC, me të dhëna nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z. Bob D'HAESELEER, këshilltar i NetZeroCities për Elbasanin • Znj. Vlatka BERLAN-VLAHEK, këshilltare e NetZeroCities për Podgoricën • Znj. Deniz CELIK, këshilltare e NetZeroCities për Sarajevën

<p>11:50 – 13:15</p>	<p>Ecim më tej së bashku: ndërtimi i aleancave lokale, kombëtare dhe rajonale për veprimin e klimës urbane. Diskutimi i tryezës së rrumbullakët i moderuar nga z. Garret Patrick KELLY, Koordinator i Sarajevës, NetZero City</p> <p><i>Ngritja e rrjeteve kombëtare dhe rajonale të qyteteve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrjeti Rajonal i Qyteteve për Ballkanin Perëndimor: Znj. Jelena JENEVSKA, Drejtore e Programit, Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) • Rrjeti i Misionit të Qyteteve të Greqisë dhe Qipros: Z. Chrysses NICOLAIDES, Bordi i Misionit të BE-së për Qytetet Neutrale ndaj Klimës dhe Qytetet e zgjuara <p><i>Angazhimi i palëve të interesuara dhe qytetarëve në transformimet urbane</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i një aleance lokale për klimën: Z. Björn Hugosson, Kryeshefi për Klimën, Stokholm, Suedi • Qasja 'Qyteti si vend i përbashkët': Znj. Valentina Balotta, Departamenti i Planifikimit Urban, Bashkia e Bolonjës, Itali • Referues për WB <p><i>Ndërtimi i mbështetjes për veprimin e klimës urbane në nivel kombëtar</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Znj. Zana VOKOPOLA, Drejtore Ekzekutive, Instituti i Kërkimeve Urbane (Grupi i Punës Elbasan) • Përfaqësues nga Spanja ose Austria
<p>13:15 – 14:30</p>	<p><i>Pushimi i drekës</i></p>
<p></p>	<p><i>Ju lutemi mos harroni të nënshkruani listën e pjesëmarrjes</i></p>
<p>14:30 – 16:00</p>	<p>Rrugëtimet e qytetit drejt neutralitetit klimatik: nga planifikimi në zbatim. Sesioni i moderuar nga z. Bob D'HAESELEER, këshilltar i NetZeroCities për Elbasanin.</p> <p>Me shembuj nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Folës nga BE (pjesa e mbetur e ekspertëve të Taiex) • Znj. Branka KNEZEVIC, Koordinatore e Programit të Misionit të qytetit të BE-së, Podgorica • Znj. Aulona Bylykbashi, Nen kryetare e Bashkise Elbasan • ...Sarajevë (nënkryetar)
<p>16:00 – 16:30</p>	<p><i>Pushim ndërveprues</i></p>
<p>16:30 – 17:00</p>	<p>Perspektiva për veprimin mbu klimën urbane: njohuri nga studiues dhe praktikues. Prezantimi nga znj. Mirela MUCA, Drejtore Ekzekutive, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Shqipëri.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Znj. Kirsten Dunlop, CEO e EIT Climate-KIC • Z. Yves Dejaeghere, Drejtor Ekzekutiv, Federata për Inovacion në Demokraci – Evropë • Dr. Damir Kapidžić, Profesor i Asociuar, Universiteti i Sarajevës, Studiues / Vizitor Fulbright, Universiteti i Harvardit

17:00 – 18:15	<p>Financimi i tranzicionit të gjelbër dhe inteligjent në qytetet e Ballkanit Perëndimor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Znj. Adelina FARICI, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Lokale, Shqipëri • Z. Ilir BEQJA, Drejtor, Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC), Shqipëri • Znj. Nermina SULJEVIĆ, Sarajevë • Znj. Teodora KUSOVAC, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Kryeqyteti Podgoricë • Kryetar nga BERZH (zyra e BB) • Folës nga EIB (zyra e BB) • Folës nga Delegacioni i BE-së (kontrolloni me ta për sugjerimet e folësve, p.sh. për burimet e financimit të BE-së për qytetet e Ballkanit)
18:15 – 18:30	<p>Sesioni përmbyllës (mësimet e nxjerra dhe një thirrje për veprim për klimën urbane në BB)</p>
18:30 – 20:30	<p>Pritje ndërvepruese (rrjetëzimi) e ofruar nga Bashkia Elbasan</p>

DRAFT

TAIEX

MOVING FORWARD TOGETHER
WITH EU EXPERTISE

Annual Activity Report

EN: europa.eu/lbxCcUp

FR: europa.eu/lVgYK9J

DE: europa.eu/lKmmd4b



near-taix@ec.europa.eu



ec.europa.eu/taix



@eu_near | #EUTaix



facebook.com/EUNEAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE STRATEGJIKE DHE INOVACIONIT

Nr. 4700 Prot.

Elbasan, më 26 .09. 2023

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare të aktivitetit

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

Këtu

Në mbështetje të bashkëpunimit që Bashkia Elbasan ka tashmë me Komisionin Europian, insitucionalizuar nëpërmjet aplikimit që Institucioni ynë realizoi, më datë 27/01/2022, me nr.398 prot, paraqitur pranë Komisionit Europian, nëpërmjet edhe "Letër angazhimit", për t'u bashkuar me Sekretariatit e Misionit të Qyteteve të BE-së, të misionit të qyteteve neutrale klimaterike, nga ku; me datë:26/04/2021, ka marrë miratim nga Komisioni Europian, për të qenë pjesë: "Misioni i Bashkimit Europian për 100 qytete neutrale klimatike dhe të zgjuara deri në vitin 2030", Ju informojmë së vazhdojmë bashkëpunimin tonë të frytshëm me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet që janë pjesë e familjes së madhe europiane, fituese në këtë program.

Në këtë kuadër rrjeti i bashkëpunimit midis vendimmarrësve pjesë e grupit të misionit të BE-së për 100 qytetet neutral klimatike dhe te zgjuara deri ne vitin 2030, kanë planifikuar të realizojnë më datë 24 Tetor 2023, workshopin me TAIEX¹ mbi misionin e qyteteve të Ballkanit Perëndimor të Horizontit Europian në qytetin e Elbasanit.

Komisioni Europian sëbashku me TAIEX po mbështet Bashkinë Elbasan në mbulimin e shpenzimeve me akomodim dhe udhëtim për 70 të ftuar paraprak nga Ballkani Perëndimor dhe vendet e Bashkimit Europian sipas axhendës që do të gjeni bashkangjitur kësaj kërkesë.

Ndërkohë, kërkojmë nga strukturat e buxhetit, në Bashkinë Elbasan të planifikojnë mbulimin e shpenzimeve si më poshtë:

¹ Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX), i financuar nga Komisioni Evropian dhe i synuar për vendet e Ballkanit Perëndimor, vendet e Fqinjësisë Jugore dhe Partneritetit Lindor, përfituesit e Instrumentit NDICI, si si dhe disa shtete anëtare të BE-së.

- logjistikën për 70 të ftuarve nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Europian (lëvizjet nga Aeroport-Hotel, ndjekjen e workshopit dhe hotel-aeroport për kthimin)
- darkë mirseardhje për të ftuarit nga Bashkimi Europian dhe ballkani perëndimor, me aktivitete prezantuese për Elbasanin
- shpenzimet e vizibilitetit për realizimin e workshopit (sipas axhendës që po ju bashkangjisim).

Gjithashtu, Bashkia Elbasan duke e ndarë praktikën me të tjerë përfaqësues, staf të institucioneve qendrore dhe vendore në Shqipëri ka njoftuar për pjesëmarrje edhe 80 pjesëmarrës paraprak në konferencë ku planifikon të mbulojë shpenzimet si:

- paketa ushqimore (katering) ditore si: kafet, vaktet e ushqimit etj sipas axhendës.

Grupi i punës, pranë Bashkisë Elbasan referuar urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, z.Gledian Llatja, me nr.2578/3 prot, datë 01/05/2023 për aktivitetet përgatitore dhe kontratën e qytetit klimatik ka përlllogaritur shpenzimet totale që do të mbulojë institucioni ynë në shumën 1.900.000 lekë.

Ju lutem, të merret në konsideratë mbulimi i shpenzimeve të cituara si domosdoshmëri për të realizuar me sukses workshopin e ndarjes së përvojës midis qyteteve të Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor, për të punuar më pas së bashku në transformimin e neutralitetit klimatik për qytetin tone edhe sipas planifimit dhe zbatimit të veprimtarive të tjera konkrete në vazhdimësi për të arritur qëllimin tonë të përbashkët në Misionin e Qyteteve Neutrale ndaj Klimës dhe Qyteteve inteligjente, si vlerë e shtuar për qytetin dhe komunitetin në Bashkinë Elbasan.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Specialiste SIEPHI: A.Çerma

Specialist SIEPHI: B.Alterziu

Pranoi: Përgjegjëse SIEPHI: K.Kreka

Miratoi: Drejtor DIEPSI: K.Qosja

Drejtor PPSSSHKTIM: E.Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Elbasan më _____ . 10 2023

P/VENDIM

NR. _____ DATË _____ . 10. 2023

“Për një ndryshim të VKB-së nr 80 datë 13.09.2023 “ Lidhja nr 8 “ Mbi Nivelin e pagave të Qendrës së Artit “

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ .10.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Për një ndryshim të VKB-së nr 80 datë 13.09.2023“ Lidhja nr 8 “ Mbi Nivelin e pagave të Qendrës së Artit “, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015“Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma ç, neni 26, neni 27, neni 33, neni 54 gërma d dhe dh, ligji nr 9936 datë 26.06.2023 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 8, si dhe Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, bazuar në relacionin e paraqitur në mbledhjen e datës _____ .10.2023.

VENDOSI:

1. Të miratojë tabelën e nivelit të pagave Lidhja nr 8 .pika 4 me ndryshimet sipas tabelës bashkëngjitur relacionit .
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Administratës ,Burimeve Njerëzore dhe Monitorimit të performancës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Qendra e Artit.

3. Marredhëniet financiare fillojnë nga data 1 prill 2023.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Koncept:

D Buxhet /Finance A Merkja

D Burime Njerëzore E Tafani

D Drejtorisë Juridike A Hoxha

Konfirmoi;

D I përgjith Administrates A Lulja

D.P.P.A.B.F D Q Tusha

Pranoi; Zv/Kryetar V Lico

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

KRYETAR

Lutfi LALA